

VENDIM
Nr. 649, datë 31.10.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozim të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës C, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSO-NAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së
(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANI-
ZATAT ISIL (Da’esh) DHE AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL
(Da’esh) dhe Al-Qaida”;

1. ANJEM; CHOUDARY; na; na

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.